



MARREVESHJE BASHKEPUNIMI

NDËRMJET

**MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
UJRAVE**

DHE

“RROMANI BAXT ALBANIA”

Tiranë

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

“Rromani Baxt Albania”, OJF, e regjistruar me Nr identifikimi _____, në datë _____, me objekt të veprimtarisë “Zhvillimin e aktivitetit mjedisor për mbajtjen pastër të mjediseve urbane, edukimin për kulturë qytetare ekologjike, parandalimin e trafikimit të fëmijëve e përfshirjes së tyre në lypjen e detyrueshme” me adrese në Rruga: Halit Bega Nr.28 Allias Kinostudio TIRANA, Albania, Tel/Fax – 00355 4 368 324, përfaqësuar nga z. Pellumb “Gimi” Furtuna, alrromanibaxt@hotmail.com, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv,

DHE

Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave (MMPAU), Person Juridik Publik, e cila harton dhe zbaton politika, strategji, programe dhe projekte, të cilat synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mjedisit, përbërësve të tij dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve duke synuar në rritjen e nivelit ekonomik dhe të cilësisë së jetës së brezave të sotëm dhe atyre që do të vijnë, me adresë: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë, - Tel: 2 270 630, Fax: 2 270 627 - www.moe.gov.al, përfaqësuar nga Z.në cilësinë e të Ministrisë.

Duke qënë se “Rromani Baxt Albania” ka si objekt të aktivitetit të vet grumbullimin në burim të mbetjeve urbane të riciklueshme;

Duke qënë se MMPAU është duke proceduar me ndarjen në burim të mbetjeve të riciklueshme si letra, plastika,kanacet dhe mbetjet e tjera në mjediset e saj;

Me synimin e përbashkët përmirësimin e vazhdueshëm e të qëndrueshëm të mjedisit;

Me angazhimin e reduktimit të mbetjeve dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore;

Palët e mësipërme, bazuar në parashikimet e Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”,

bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Përcaktimi i rregullave dhe modaliteteve mbi të cilat palët do të kryejnë procedurat përkatëse për tërheqjen periodike të mbejeteve urbane të riciklueshme sic përcaktohet në këtë marrëveshje.

Neni 2

Angazhimet e palëve

2.1 MMPAU angazhohet të ndajë në burim mbetjet urbane të riciklueshme në koshat përkatës (Letër, Plastikë dhe Kanace) nga ato organike brenda kushteve dhe parametrave të lejuar.

2.2 Rromani Baxt Albania angazhohet në tërheqjen e këtyre mbetjeve sipas kalendarit të përcaktuar mes palëve bazuar në legjislacionin mjedisor dhe në zbatim të lejes mjedisore përkatëse të disponuar.

2.3 Rromani Baxt Albania angazhohet në zbatimin e legjislacionit mbi ruajtjen e konfidencialitetit deri në mberitjen e mbetjeve në fabrikën e riciklimit.

2.4 Rromani Baxt Albania do të asistohet nga MMPAU si partner kontribues për aktivitetin në ndihmë të edukimit të gjithanshëm të fëmijëve rom. Të ardhurat modeste që sigurohen do të përdoren për të mbështetur veprimtari parandaluese të trafikimit të fëmijëve rom, lypjen e detyruar, aktivitetin e kopshtit parashkollor, të shkollës verore e të gjitha veprimtarive promovuese të integritetit të brezit më të ri rom në shoqërinë e sotme demokratike.

2.5 Palët angazhohen të mbështesin njëra tjetrën në realizimin e veprimtarive të përbashkëta me interes reciprok.

2.6 Palët do të bashkëpunojnë edhe në forma të tjera të bashkëpunimit, për të cilat mund të bien dakord në të ardhmen.

Neni 3

Komunikimi mes Palëve

3.1 Palët komunikojnë në mënyrë të ndërsjelltë dhe shkëmbejnë informacion të nevojshëm në përmbushje të qëllimeve të kësaj Marrëveshje. Komunikimi do të kryhet nëpërmjet cdo forme si telefon, fax, email, korrespondencë shkresore etj.

3.2 Palët caktojnë një person kontakti përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshje, dhe përkatësisht si vijon:

1. Për MMPAU, Person kontakti do të jetë z. _____ në cilësinë e tij si _____.
2. Për “Rromani Baxt Albania” Person kontakti do të jetë z. Pellumb “Gimi” Furtuna, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, me adrese emaili: alrromanibaxt@hotmail.com

3.3 Personat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe kordinimin e veprimeve me palën tjetër.

Neni 4

Dispozita të fundit

4.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një afat të pacaktuar dhe ajo do të jetë efektive përsa kohë do të gjykohet si i nevojshëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi mes palëve.

4.2 Cdo palë mund të kërkojë zgjidhje të marrëveshjes duke njoftuar me shkrim palën tjetër jo më pak se 4 javë kalendarike përpara.

4.3. Megjithatë cdo kërkesë për zgjidhje të marrëveshjes do të bëhet efektive, vetëm nëse palët kanë përmbushur detyrimet e marra përsipër deri në momentin e zgjidhjes.

4.4 Marrëveshja mund të amendohet në çdo kohë bazuar në pëlqimin me shkrim të palëve dhe në mënyrë periodike do të vlerësohen arritjet.

4.5. Palët në këtë marrëveshje do të bëjnë të gjitha përpjekjet për realizimin sa më efektiv të të gjitha detyrimeve të marra përsipër.

4.6. Kjo Marrëveshje është e një natyre tërësisht Bashkëpunuese. Ajo nuk krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.

4.7. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.
Përfaqësuesit zyrtarë të palëve firmosin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi.

4.8. Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje origjinale, një për seicilën palë.

Nënshkruar në Tiranë më.....

PËRFAQËSUESI PËR
“Rromani Baxt Albania”,

Pellumb “Gimi” Furtuna
Drejtore Ekzekutive

PËRFAQËSUESI PËR
**Ministria e Mjedisit, Pyjeve
dhe Administrimit të Ujërave**

.....
.....